

PROF. ASOC. DR. SONILA BOÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
sonilaboci23@gmail.com

**TRAJEKTORJA E NJË KULTI: ENVER HOXHA
DHE SENDËRTIMI I UDHËHEQËSIT STALINIST
(1944-1948)****Abstrakt:**

Artikulli “Trajektorja e një kulti: Enver Hoxha dhe sendërtimi i udhëheqësit stalinist (1944-1948)” shqyrton procesin e ngjizjes dhe konsolidimit të kultit të individit rreth Enver Hoxhës në vitet e para të regjimit komunist shqiptar. Duke u mbështetur në burime arkivore, dëshmi të bashkëkohësve dhe dokumente të brendshme partiake, studimi heton mënyrën se si një figurë pa përvojë të gjatë revolucionare dhe me kontakte të kufizuara me lëvizjen bolshevike arriti të ngjitej në krye të Partisë Komuniste të Shqipërisë (PKSH) dhe, më pas, të shndërrohej në qendër të legjitimitetit të pushtetit totalitar.

Analiza ndalet në tri faza të këtij procesi: ngjitja e Hoxhës në udhëheqje përmes një zinxhiri rastësish të favorshme dhe aftësisë për të menaxhuar konfliktet fraksioniste; transformimi i figurës së tij nga “komandant popullor” në “udhëheqës partie” gjatë viteve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe menjëherë pas saj; dhe, së fundi, konsolidimi i autoritetit të tij absolut në periudhën 1946-1948, përmes ndërthurjes së propagandës, kontrollit politik dhe instrumentalizimit të krizave ndërpartiake e ndërkombëtare. Në këtë kuadër, artikulli analizon edhe rolin e bashkëpunëtorëve si Miladin Popović-i, Nako Spiru e Koçi Xoxe, për të kuptuar mekanizmat e përplasjes dhe të përvetësimit të pushtetit. Studimi argumenton se kulti i Hoxhës nuk ishte një produkt spontan i adhurimit popullor, por një konstrukt politik i përpunuar, që ndërthuri elemente të traditës autoritariste shqiptare me modelet staliniste të legjitimitetit. Përmes këtij procesi, Hoxha jo vetëm siguroi mbijetesën e tij politike, por vendosi edhe themelet ideologjike dhe institucionale të totalitarizmit shqiptar në dekadat që pasuan.

Fjalë kyç:

Kulti i individit, Enver Hoxha, totalitarizëm, Partia Komuniste e Shqipërisë, propagandë.

Hyrje

Mbrëmjen e 9 prillit 1985, në orën 22:00, numri “dy” i regjimit mblodhi me urgjencë Plenumin e KQ të PPSH-së dhe sekretarët e parë të komiteteve të partisë së rretheve. Qëllimi i takimit ishte njoftimi për gjendjen kritike shëndetësore të Sekretarit të Parë të KQ të PPSH-së, Enver Hoxhës. Në 20 minutat e tij, Ramiz Alia udhëzoi drejtuesit politikë për marrjen e masave në rast të vdekjes së drejtuesit të shtetit totalitar shqiptar, me qëllim ruajtjen e “unitetit të Partisë me popullin” dhe shmangien e panikut dhe demobilizimit të popullsisë.¹ Kjo mbledhje ishte shumë më tepër se një thirrje mobilizuese. Ajo nxirrte në pah një të vërtetë të njohur brenda sistemit: figura e Enver Hoxhës ishte bërë për katër dekada baza e legjitimitetit politik dhe garancia simbolike e qëndrueshmërisë së regjimit. Kulti i tij nuk ishte më një fenomen propagandistik, por baza e arkitekturës së brendshme të pushtetit.

Historiografia shqiptare ka pak studime të cilat kanë në qendër Enver Hoxhën,² ndërsa i mungojnë studime mbi arkitekturën e kultit të individit të ngritur rreth tij. Ky studim nuk ka për qëllim të jetë një biografi e Enver Hoxhës, por të përqendrohet në mekanizmat legjitimues të autoritetit të Enver Hoxhës. Ai synon të kthehet pas në vitet e para të regjimit komunist, për të analizuar procesin e ngjizjes së këtij kulti dhe mënyrën se si, ndërmjet viteve 1944-1948, figura e Hoxhës u transformua

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Arkivi i Partisë (AP)-Organet Udhëheqëse (OU), Viti (më tej: V.) 1985, Dosja (më tej: D. 1). Mbledhje e Plenumit të KQ të PPSH-së, 9 prill 1985, ora 22:00.

² Dy studime, të cilat i janë dedikuar biografisë së Enver Hoxhës janë: Blendi Fevziu, *Enver Hoxha, e para biografi bazuar në dokumentet e arkivit personal dhe në rrëfimet e atyre që e njohën* (Tiranë: UETPress & Klan, 2011); Vasfi Baruti, *Enver Hoxha, gjysma tjetër e hënës* (Tiranë: ISKK, 2007). Të dyja biografitë synojnë rikonstruktimin e kultit të ndërtuar rreth Enver Hoxhës dhe rishkrimin e një historie më objektive.

nga drejtues partie në përfaqësuesin e vetëm të partisë dhe të shtetit. Periudha e parë e pasluftës përfaqëson një moment themelor në procesin e ndërtimit të totalitarizmit shqiptar, kur pushteti politik ende nuk kishte konsoliduar plotësisht bazat e tij institucionale, ndërsa lufta për legjitimitet zhvillohej edhe brenda vetë hierarkisë së partisë.

Duke u mbështetur në dokumente arkivore, kujtime dhe burime të brendshme partiake, artikulli heton se si u ndërtua imazhi i “udhëheqësit të lindur” dhe si u krijua mekanizmi i identifikimit të partisë me liderin. Në këtë mënyrë, analiza synon të ndriçojë procesin e formimit të kultit politik në Shqipëri, si pjesë e logjikës së legjitimitetit të pushtetit në vitet e para të regjimit komunist.

Nga anonimati në udhëheqje: Formimi dhe ngjitja e Enver Hoxhës në Partinë Komuniste të Shqipërisë

Dekadë pas dekadë, sikurse vetë Enver Hoxha kishte punuar në kujtimet e tij të shumta, ashtu edhe makineria propagandistike e krijuar prej tij, si dhe historiografia e periudhës, formësoi për të imazhin e një revolucionari të hershëm, organizuesit të rezistencës antifashiste shqiptare, si dhe ideatorit, themeluesit dhe drejtuesit *sui generis* të PKSH-së dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare.³ Të gjitha këto ishin përpjekje për të legjitimuar kultin e tij të individit, si një autoritet moral, i cili vepronte në interes të shoqërisë. Në të vërtetë, ngritja e Enver Hoxhës në pozitë drejtuese të PKSH-së është një rast që nuk ka shumë të ngjashëm. Ndryshe nga shumë drejtues të partive komuniste në Europën Qendrore e Lindore, të cilët kaluan vite të tëra në veprimtari ilegale, shpesh të ndjekur, kontrolluar dhe duke pasur mbi supë edhe vite të gjata dënimesh, Enver Hoxha e kaloi këtë periudhë, në dukje, në kërkim të një identiteti

³ “Enver Hoxha, i frymëzuar nga dëshira e flaktë për ta arritur sa më parë bashkimin e komunistëve shqiptarë në një parti të vetme, nuk ishte tërhequr përpara vështirësive të reja që kishin lindur nga puna fraksioniste e të rinjve dhe zjarristëve. Ai gjeti një gjuhë të përbashkët me aktivistët e shquar të Grupit të Shkodrës, Vasil Shanton e Qemal Stafën. Dega e Tiranës, e drejtuar nga Enver Hoxha, u bë dalëngadalë qendra e vërtetë organizative për të gjithë lëvizjen komuniste dhe antifashiste në Shqipëri”. *Shih: Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, botim i Institutit të Studimeve Marksiste-Leniniste, pranë KQ të PPSH-së (Tiranë: 8 Nëntori, 1981), 60; *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqipërisë*, vëll. 1 (Tiranë: 8 Nëntori, 1984), 194. Kjo tezë është elaboruar gjerësisht në kujtimet e Enver Hoxhës. *Shih: Enver Hoxha, Kur lindi Partia, Kujtime* (Tiranë: 8 Nëntori, 1981), 92-137.

ideologjik. Vendosja e tij në krye të PKS-së i dedikohet më së shumti rastësisë sesa dedikimit të tij të hershëm revolucionar, çka e bën studimin e ngjizjes së kultit të tij të individit edhe më interesant.

Enver Hoxha, në faqet e kujtimeve që shkroi, u kujdes të vizatonte imazhin e një revolucionari komunist të hershëm. Sipas tij, gjatë qëndrimit në Paris, pas ndërprerjes së bursës nga Ministria e Arsimit më 1933, ai vendosi kontakte me qarqet komuniste franceze dhe literaturën marksiste, leniniste dhe staliniste.⁴ Nuk ka asnjë çudi që atmosfera politike pariziane e fillimviteve '30, e mbartur me lëvizje të fuqishme të së majtës komuniste, mund të ketë tërhequr vëmendjen e Hoxhës së ri. Ajo çka burimet nuk e mbështesin është roli i tij aktiv në këto zhvillime. Pavarësisht kërkimeve të shumta të kryera në vitin 1987 nga historianë të regjimit, nuk u gjetën prova që Enver Hoxha të kishte bashkëpunuar me gazetën "Humanité", organ i Partisë Komuniste Franceze, nën pseudonimin Lulo Malësori.⁵ Po ashtu, nuk ka asnjë të dhënë që ai të ketë bashkëpunuar me gazeta të së majtës në emigracion, siç ishte "Liria Kombëtare", organ i Komitetit Nacional Revolucionar (KNÇ), i cili ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me Internacionalen Komuniste.

Përkundrazi, shkrimet e pakta që mbajnë nënshkrimin e tij gjatë viteve '30 në gazetën "Demokratia" të Gjirokastrës dhe "Illyria" e paraqesin më shumë si një të ri patriot e progresist, të influencuar nga iluminizmi francez, socializmi radikal sesa si një aktivist të së majtës bolshevike. Nëse shkrimi në formë recense për librin e Édouard Herriot-it, *Créer*, botuar në "Illyria" me pseudonimin *Tre Yje*, ka vërtet autor Enver Hoxhën, atëherë adhurimi që ai shprehte për idetë e Herriot-it, të cilat duhej të "lexoheshin dy dhe tri herë nga çdo shqiptar i lexuar", dëshmon se prirjet e tij politike të asaj periudhe shkonin drejt së majtës më centriste.* Lidhjet familjare dhe shoqërore të Hoxhës në Paris i

⁴ Enver Hoxha, *Vite të rinisë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1988), 198-200.

⁵ Në vitin 1987, një delegacion i ngarkuar nga KQ i PPSH-së u dërgua në Francë dhe Belgjikë për të zbuluar veprimtarinë revolucionare të Hoxhës atje, por u kthye në Shqipëri pa sjellë burimet e pretenduara. Fevziu, *Enver Hoxha*, 38.

* *Édouard Herriot* (1872-1957) është një nga personalitetet më jetëgjata dhe më me ndikim të Partisë Radikale-Socialiste, duke mishëruar idealet e republikës, laicitetit dhe arsimit publik. Ai shërbeu disa herë si kryeministër i Francës: në vitet 1924-1925, 1926 dhe 1932. Një episod i debatueshëm në jetën e tij politike ishte vizita në Bashkimin Sovjetik në vitin 1933. Herriot-i u ftua nga autoritetet sovjetike dhe vizitoi Ukrainën në kulmin e urisë së madhe (Holodomor), e cila kishte shkakuar miliona viktima. Në vend që të denonconte gjendjen reale, ai pranoi versionin zyrtar të regjimit

siguruan kontakte më së shumti me Ali Këlcyrën, Kol Tromarën, Qazim Këlcyrën etj., anëtarë të organizatës *Bashkimi Shqiptar*, një organizatë më e prirë ndaj së majtës socialiste e socialdemokrate.⁶

Pavarësisht këtyre ndikimeve, Enver Hoxha nuk është i vetmi personazh historik që ka pësuar transformime në qëndrimet dhe pikëpamjet e tij politike e ideologjike. Rikthimi i tij në Korçë më 1937 si profesor me kohë të pjesshme përkon me një moment vendimtar, i cili duket se e orientoi Hoxhën drejt një transformimi gradual ideologjik, duke e vendosur në kontakt me grupet revolucionare me prirje bolshevike të qytetit juglindor. Grupi komunist i Korçës, në kohën kur Enver Hoxha u rikthye në Liceun Francez, kishte përfaqëuar platformën e Internacionales Komuniste për frontet popullore. Madje, ai kishte mundur të depërtonte disa prej anëtarëve të tij në një sërë organizmash lokalë, përfshirë edhe këshillin bashkiak të qytetit.⁷

Gjithsesi, ashtu siç ka pohuar vetë E. Hoxha në Plenumin e Beratit, ai kishte qenë një simpatizant dhe jo anëtar i Grupit komunist të Korçës.⁸ Nga të gjitha kërkimet e deritanishme, emri i Enver Hoxhës nuk përmendet në asnjë nga dokumentet e lëvizjes revolucionare të viteve '30. Koço Tashko, drejtuesi i Grupit komunist të Korçës dhe njeriu që shërbeu si promovues i tij, tregon se kontaktin e parë me Hoxhën e pati vetëm dy ditë para pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Asokohe, në Korçë ishte ngritur një komision për të regjistruar vullnetarë me të rinj nga “të gjitha rrymat”, ndër të cilët ishte edhe Enver Hoxha. Ndonëse kujtimet janë shkruar më 1948, kur kulti i tij kishte zënë tashmë rrënjë, Tashko nuk e fsheh se Hoxha nuk luante ndonjë rol parësor në lëvizjen

stalinist, duke deklaruar se nuk kishte parë asnjë shenjë urie. Në shkrimin e tij, Enver Hoxha bën thirrje për aplikimin e ideve të Herriot-it në fushat e arsimit, kulturës dhe zhvillimeve demografike në Shqipëri. Nëse shkrimi ka vërtet autor Enver Hoxhën, ai është një dëshmi e metamorfozës së tij ideologjike, nga humanizmi republikan i Herriot-it te dogmatizmi bolshevik stalinist.

⁶ Hoxha, *Vite të rinisë*, 197. Për një takim ndërmjet Enver Hoxhës dhe Ali Këlcyrës, i cili nuk kishte shkuar fort mirë, dëshmon edhe vajza e tij, Hana Këlcyra. Ajo, gjithashtu, përmend se takimi ishte zhvilluar me rekomandimin e kunatit të Enver Hoxhës, Bahri Omari. *Shih: Fevziu, Enver Hoxha*, 44.

⁷ *AQSH*, F. 15/AP, V. 1938, D. 29, fl. 16. Raport i Koço Tashkos dërguar Kominternit, maj 1938.

⁸ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi II i KQ të PKSH-së, 23-27 nëntor 1944*, përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi (Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996), 153.

revolucionare të qytetit. Ai shprehet se “kuptova që atë e kishin neglizhuar”, çka nënkuptonte se nuk ishte afuar nga drejtuesit e Grupit komunist të Korçës.⁹ Për herë të parë, një dokument mbi aktivitetin e tij revolucionar dhe antifashist përbën pjesëmarrja në demonstratën e 28 nëntorit 1939 të zhvilluar në Korçë,¹⁰ për shkak të së cilës ai u përjashtua nga puna dhe u zhvendos në Tiranë për të punuar si duhanshitës në dyqanin “Flora”. Teksti zyrtar i Historisë së PPSH-së, botuar në vitin 1982, i atribuon Hoxhës rolin e organizatorit dhe të drejtuesit të lëvizjes komuniste në Tiranë për llogari të Grupit komunist të Korçës,¹¹ ndërsa Koço Tashko pohon se ai u angazhua në fushën propagandistike dhe u mor me redaktimin e trakteve.¹²

Historia e ngritjes së Enver Hoxhës në krye të PKSH-së së sapoformuar është një tjetër moment me shumë pikëpyetje dhe pak përgjigje. Duket se një sërë faktorësh rastësorë diktuan kthimin e tij në protagonist të ngjarjeve. Mbetet e paqartë pse Koço Tashko zgjodhi Enver Hoxhën për të qenë përfaqësues i Grupit komunist të Korçës në mbledhjen themeluese të PKSH-së. Shkak mund të ketë qenë miqësia familjare, të cilën ai vetë pohonte se e kishte, ose fakti se Hoxha i kishte bërë “përshtypjen e një të riu që desh të thesh më tepër se ç’ish thënë, që ndjente se diçka ish lënë mangut, por kufizohej prej respektit që kish për më të vjetrit”.¹³ Todi Lubonja kujton se gjatë viteve të burgut, Koço Tashko kishte pohuar se kishte zgjedhur Enver Hoxhën, pasi duhej të rregullonte ekuilibrat fetarë të grupit.¹⁴

Më tej, zinxhiri i rastësive vijon. Vendimi për të mos përfshirë në Komitetin Qendror provizor të Partisë asnjë nga ish-drejtuesit e grupeve e promovoi Hoxhën si pjesë të Komitetit Qendror të përkohshëm. Ishte ndoshta thjesht rastësi që, ndryshe nga anëtarët e tjerë të qendrorit, të cilët u shpërndanë në qarqe për të organizuar strukturat partiake, Enver Hoxha qëndroi në Tiranë dhe bashkëpunoi nga afër me Miladin Popovićin, i cili më pas do të shndërrohej në një nga mbështetësit e tij më të fuqishëm.

⁹ *AQSH*, F. 14/AP, V. 1948, D. K/25, fl. 58. Kujtime të Koço Tashkos.

¹⁰ *Po aty*, F. 152, V. 1939, D. 24, fl. 81. Shkresë e prefekturës së Korçës për ministrinë e Punëve të Brendshme, 7 dhjetor 1939.

¹¹ *Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*, 52-53.

¹² *AQSH*, F. 14/AP, V. 1950, D. K/26, fl. 30. Kujtime të Koço Tashkos.

¹³ *Po aty*, F. 14/AP, V. 1948, D. K/25, fl. 58. Kujtime të Koço Tashkos.

¹⁴ Todi Lubonja, *Nën peshën e dhunës*, Kujtime, botim II (Tiranë: Mësonjëtorja, 1998), 70.

Por këtu përfundojnë rastësitë. Pjesa tjetër e historisë dëshmoi edhe aftësitë e Enver Hoxhës për të lundruar me kujdes në situata të vështira, për të evidentuar veten dhe për t'u vendosur në krye të PKS-së. Në vitin e parë të jetës, vëmendja e partisë së sapoformuar u përqendrua në krijimin e një partie të centralizuar, me unitet dhe disiplinë, duke eliminuar frymën e grupeve të dikurshme. Në këtë proces, Hoxha, qoftë edhe për shkak të lidhjeve personale më të pakta me revolucionarët më të vjetër, qoftë për karizmën apo aftësitë e tij personale për të marrë vendime të prera e të ashpra, u dallua në përpjekjet për unifikimin e partisë.

Ka disa dëshmi mbi rolin e Enver Hoxhës në luftën kundër “fraksioneve”. Në autokritikën e tij më 1951, Tuk Jakova tregon se ishte caktuar nga Miladin Popović-i për të vëzhguar situatën në celulën e drejtuar nga Isuf Keçi, një nga anëtarët e Grupit të të Rinjve, i cili etiketohej si anarkist. Megjithëse Jakova ndoqi me kujdes veprimtarinë e celulës, ai nuk arriti të raportonte për ndonjë problem apo devijim nga “vija e partisë”. I pakënaqur nga raportimi i Jakovës, Miladin Popović-i dërgoi Enver Hoxhën, i cili “solli përshtypje të tjera të drejta që i vlejten shumë partisë”.¹⁵ Pohimet e Tuk Jakovës janë artikuluar në një kohë kur kulti i Enver Hoxhës ishte ndërtuar tashmë, por ato mbështeten edhe nga të tjera dëshmi. Kristo Frashëri ishte një nga anëtarët e Grupit të të Rinjve, i cili u përjashtua nga PKS-sja më 1941 dhe nuk u rikthye kurrë më si anëtar i saj. Në kujtimet e tij të botuara pas rënies së regjimit, ai rrëfen një histori shumë domethënëse. Në një mbledhje me përgjegjësit e celuleve të Tiranës, e cila do të miratonte rezolucionin e mbledhjes themeluese, ishte dërguar fillimisht Koçi Xoxe, një nga anëtarët e Komitetit Qendror provizor, së bashku me Miladin Popović-in. Xoxe u gjend nën një breshëri pyetjesh nga pjesëmarrësit, të cilët kërkonin të elaboronin çështje teorike, si mundësitë e një revolucioni socialist/bolshevik në Shqipëri. Mbledhja përfundoi pa realizuar qëllimin. Në mbledhjen e ardhshme, Koçi Xoxe u zëvendësua nga Enver Hoxha, i

¹⁵ AQSH, F. 14/APOU, V. 1951, D. 1/3, fl. 5. Autokritikë e Tuk Jakovës paraqitur para Byrosë Politike të KQ të PPSH-së. Rasti më i njohur është, pa dyshim, roli i Enver Hoxhës për të shtypur “fraksionin e Xhepit (Sadik Premtes)” në Vlorë, për të cilin është shkruar gjerësisht nga historia zyrtare e PPSH-së. Ajo çka bëri Hoxha dhe të tjerët nuk kishin mundur ta bënin ishte të bindnin masën e partizanëve në padrejtësinë e luftës që bënte Premtja, në mënyrë që vendimi për likuidimin e tyre fizik të fitonte legjitimitet.

cili, sipas prof. Frashërit ishte përgatitur mjaft mirë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve teorike. Fjala e tij, sipas së cilës revolucioni socialist i takonte një kohe të dytë dhe se tashmë ishte koha e një rezistence nacionalçlirimtare kishte fashitur debatin dhe miratimi i rezolutës u bë me unanimitet.¹⁶

Enver Hoxha u tregua një nxënës shumë i zellshëm, i cili u adaptua shpejt me metodat e organizimit të një partie bolshevike. Diku duke përdorur aftësitë e tij të bindjes, por më shumë duke përdorur politikën e “dorës së fortë”, Hoxha fitoi emër në procesin e unifikimit të partisë së re dhe në eliminimin e të ashtuquajturve “fraksionistë”. Gjithë procesi ndihmoi në modelimin bolshevik të PKS-së dhe në sendërtimin e veprimtarisë së saj me ato çka studiuesi rumun Vladimir Tismăneanu i karakterizon si metoda bizantine.¹⁷ Dënimet, përjashtimet dhe eliminimet fizike të anëtarëve rebelë krijuan një klimë frike dhe nënshtrimin ndaj autoritetit në anëtarësinë e partisë, çka lehtësoi procesin e krijimit të kultit të udhëheqësit.

Në këto rrethana, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm dhe mbështetjes së Miladin Popović-it, filloi ngjitja e Enver Hoxhës në krye të strukturave partiake. Në Konferencën e Pezës, ai u zgjodh një nga anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Në Konferencën I të PKS-së (mars 1943), Hoxha u ngjit në postin e sekretarit politik dhe më pas mori poste të rëndësishme në Lëvizjen Nacionalçlirimtare (LNÇ). Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ-së (korrik 1943), ai u emërua komisar i tij. Ndonëse gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare komunikimi mes drejtuesve lokalë të PKS-së dhe Enver Hoxhës kishte doza të fuqishme informaliteti dhe shpesh një ton miqësor, qenia e tij në pozicione të larta prodhoi një autoritet, i cili është e vështirë të thuhet nëse buronte nga aftësitë e tij organizuese dhe drejtuese apo nga frika.

Burimet japin indikacione për të dyja rastet. Ymer Dishnica dukej i frikësuar pasi mori letrën e Enver Hoxhës të 9 gushtit 1943, në të cilën ai akuzohej për devijim nga “vija politike” në raport me Ballin Kombëtar. Fjalja me të cilën hapet letra e tij e përgjigjes, “si bombë më ra ndër duar letra që fimosnje ti”, është dëshmi e një tronditjeje të thellë.¹⁸ Në tetor

¹⁶ Kristo Frashëri, *Jeta e një historiani*, Kujtime (Tiranë: ASHSH, 2014), 112-113.

¹⁷ Vladimir Tismăneanu, *Stalinism for All Seasons. A Political History of Romanian Communism*, (California: University of California Press, 2003), 99.

¹⁸ *AQSH*, F. 14/ Arkivi i PKS-së gjatë Luftës (më tej: APL), V. 1943, D. 21, fl. 23-27. Letër e Ymer Dishnicës për Enver Hoxhën, 14 gusht 1943.

1943, Nako Spiru, një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Enver Hoxhës gjatë luftës, vinte në dukje se E. Hoxha ishte pjekur si drejtues. “Do të bëj urime, – shprehet Spiru, – të mos të rritet mendja dhe mos e merr për keq – ti po shkon shumë përpara, shkruan gjithmonë ma mirë (ky nuk është një çkëmbim i komplimentave qi më bën për artikujt)”.¹⁹ Vlerësimi vinte pas letrës së gjatë të Hoxhës për Spirun dhe Dishnicën, në të cilën shpjegonte politikën e PKS-së ndaj Ballit Kombëtar, duke analizuar pikat e forta dhe të dobëta si të organizatës që drejtonte, ashtu edhe të kundërshtarit, si dhe duke përpiluar një strategji, e cila, në perspektivë, rezultoi e suksesshme për marrjen e pushtetit nga PKS-ja.

Pavarësisht këtyre, fakti që shumë nga drejtuesit lokalë të PKS-së, apo strukturave ushtarake të LNÇ-së vijonin veprimtarinë për një kohë të gjatë pa kontakte me drejtuesit qendrorë, apo që disa urdhra të firmosur nga Hoxha si, për shembull, ata për eliminimin e disa komunistëve të konsideruar fraksionistë nuk u zbatuan, për shkak të dyshimeve mbi legjitimitetin e tyre, dëshmon se gjithsesi besimi dhe besnikëria ndaj autoritetit të Hoxhës brenda hierarkisë së organizatës ishte ende i diskutueshëm.²⁰

Ai nuk mundi të ushtronte autoritet të spikatur jashtë strukturave partiake dhe të kontribuonte në ngjizjen e një fronti me të vërtetë popullor. Më vonë, Hoxha pranon se dështimi i Konferencës së Pezës ishte edhe për shkak të përvojës dhe aftësive të tij. “Ne kishim turp, – do të pranonte ai në Plenumin e Beratit, – s’ishim njerëz të turmave. Unë s’isha në gjendje të mbroja tezën me nacionalistët. Unë dola të lexoja atë referatin por që të mbroj tezën jo. Me një përgatitje të tillë do të dilnin ato teza që dolën, do të dilnin ato gjëra qesharake”.²¹

Studiuesja Sheila Fitzpatrick na kujton se një nga karakteristikat themelore të një partie bolshevike është lideri i fortë i tipit diktatorial.²² Nuk ka dyshim se gjatë viteve të rezistencës, Enver Hoxha arriti të krijonte një emër për veten e tij. Direktivat, udhëzimet dhe kërkesat e tij,

¹⁹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 20, fl. 4-7. Letër e Nako Spirit për Enver Hoxhën, 8 tetor 1943.

²⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1943, D. 26, fl.17-28. Letër e Gogo Nushit për Enver Hoxhën, 16 tetor 1943, në të cilën i shkruan se për Anastas Plasarin “neve nuk jemi të mendimit tuaj”.

²¹ *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës*, 153.

²² Sheila Fitzpatrick, *The Russian Revolution*, Second edition (Oxford University Press, 2001), 81.

herë me ton shoqëror, herë autoritar e definitiv e bënë të njohur, të paktën brenda gjirit të bashkëpunëtorëve të afërt dhe drejtuesve të strukturave politike dhe ushtarake. Duke filluar nga gushti i vitit 1942, ai dha një kontribut jo të paktë në propagandimin e PKSH-së dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke shkruar një numër të konsiderueshëm artikujsh për organin e KQ të PKSH-së, “Zëri i Popullit”.

Por a mundi ai të legjitimonte veten si një lider me autoritet të pakufizuar? Janë dy faktorë që duhen marrë parasysh në lidhje me legjitimitetin e autoritetit të tij gjatë Luftës së Dytë Botërore. *Së pari*, autoriteti i tij, sidomos brenda rrethit të ngushtë të bashkëpunëtorëve, sfidohej nga prezenca e dy organizatorëve jugosllavë. Dy jugosllavët konsideroheshin më me përvojë dhe përfaqësues të një partie me kontribute në lëvizjen komuniste botërore. Duke marrë në konsideratë traditën politike shqiptare për një lloj nënshtrimi ndaj këshillave të të huajve, ata kishin një përparësi të dukshme në drejtimin e partisë së sapokrijuar. *Së dyti*, Enver Hoxha veproi në ilegalitet të thellë, veçanërisht pas demonstratës së shumëpërmendur të 28 tetorit 1942, duke mbajtur kontakte vetëm me një numër të kufizuar drejtuesish e organizatorësh të lëvizjes. Todi Lubonja, një nga pjesëmarrësit në LNÇ shprehet se lufta përbënte një realitet shumë të ashpër, në të cilin “shumë-shumë mund të të shkonte në mendje nëna dhe babai”. Në kushtet e ilegalitetit ishin të paktë ata që gjatë luftës “kanë njohur, takuar, apo ditur kush ishte Enver Hoxha”.²³

Kulti në embrion: Enver Hoxha dhe transformimi i autoritetit pas Kongresit të Përmetit

Në pranverën e vitit 1944, situata politike në Shqipëri ndryshoi drastikisht në favor të LNÇ-së dhe PKSH-së. Raportet gjermane dhe britanike dëshmojnë për një rritje të prestigjit të UNÇ-së, veçanërisht në jug të Shqipërisë. PKSH-ja, e vendosur për të hedhur hapin e radhës drejt pushtetit, filloi të riorganizonte strukturat e saj lokale dhe të përzgjidhte delegatët për në Kongresin e Përmetit. Në të gjitha zonat e kontrolluara nga LNÇ-ja u mblodhën aktivet e PKSH-së, të cilat diskutuan rreth situatës. Dokumentet e prodhuara prej tyre, veçanërisht përshëndetjet që i

²³ Lubonja, *Nën peshën e dhunës*, 316-317.

dërguan Komitetit Qendror të PKSH-së, janë shumë interesante për të kuptuar dinamikën e ngritjes së kultit të Enver Hoxhës.

Gjatë muajve prill-maj 1944, përshëndetjet e drejtoreshin Komitetit Qendror të PKSH-së si një trup kolegjal, pa veçuar asnjë prej anëtarëve të tij. Gjuha është panegjrike. Komiteti Qendror konsiderohej si: “udhëheqësi xhential në këtë luftë vigane të popullit tonë, që, edhe në çastet më kritike, ka mundur të dërgojë dritën udhëheqëse në të gjitha (te të gjithë); “shtyllë e fortë”; “dorë e çeliktë”; “pararojë e pathyeshme e Luftës Nacionalçlirimtare të popullit tonë kundra okupatorit barbar fashist dhe agjentave të tij”; “mbrojtëse e madhe të Rinis shqiptare nga demagogjia, korrupsioni dhe arma e okupatorit fashist”.²⁴

Pas Kongresit të Përmetit (24-28 maj 1944), gjatë muajve qershor dhe në vijim, Enver Hoxha filloi të përmendet gjithnjë e më shumë, të paktën në një masë të konsiderueshme të pjesëmarrësve të LNÇ-së. Krijimi i strukturave provizore të qeverisjes, zgjedhja e Hoxhës si kryeministër i vendit dhe komandant i Përgjithshëm i UNÇ-së, si dhe vendosja e gradës gjeneralkolonel, ishin edhe mekanizma për ta evidencuar atë në sytë e publikut të gjerë. Nga ana tjetër, ndonëse pa ndonjë platformë të qartë dhe të koordinuar, filloi procesi i “popullarizimit të komandantit”. Dokumentet dëshmojnë për një proces që nuk ishte i unifikuar. Kështu, në një përshëndetje të aktivitetit të komitetit qarkor të PKSH-së për Korçën, drejtuar Komitetit Qendror nuk përmendet personalisht Enver Hoxha. Ai kufizohej të përmendte “përkrahjen e shëndoshë të KQ”, e cila do të mundësonte kryerjen e detyrave “me vendosmëri komuniste ... do ta ruajë Partinë si sytë e ballit dhe do ta mprojë nga të gjithë elementat anti-parti, dhe do të mbajë lart e të papërkulur FLAMURIN E MARX-it, ENGELS-it, LENINIT dhe STALINIT deri në fitoren e fundit të kauzës së proletariatit”.²⁵ Edhe aktiviteti i Rinisë Komuniste të Shqipërisë (RKSH) për Elbasanin, në përshëndetjen e tij, ka të njëjtën frymë kolegjaliteti. “Na të ri

²⁴ AQSH, F. 14/APL, V. 1944, D. 103, fl. 1. Përshëndetje për PKSH-në nga Konferenca e dytë e Bashkimit të Rinisë Antifashiste Popullore e qarkut të Gjirokastrës, 20 prill 1944; *po aty*, fl. 7. Përshëndetje e aktivitetit të Brigadës VIII Sulmuese për Komitetin Qendror të PKSH-së, 24 maj 1944.

²⁵ *Po aty*, fl. 8. Përshëndetje e aktivitetit të komitetit qarkor të Korçës drejtuar KQ të PKSH-së, 20 korrik 1944.

komunista, – thuhet në të, – të mbledhun në aktivin II të qarkut, përshëndesim në ju, udhëheqësit e mëdhenj të partisë sonë heroike”.²⁶

Tonet e vlerësimit ndaj Enver Hoxhës nga qarqet e tjera shfaqin variacione të ndryshme. Disa letra i drejtohen në mënyrë kolektive Komitetit Qendror të PKSH-së, ndërsa Enver Hoxha përshëndetet në fund si sekretari politik i saj. Kështu, p.sh., në përshëndetjen e aktivit të PKSH-së për Vlorën thuhet: “Me bindje në punë, me besim e dashuri ndaj partisë s’onë heroike dhe nën udhëheqjen e ndritshme të Komitetit Qendror, në krye të të cilit qëndron shoku ynë i dashur Enver Hoxha, do të mbajmë lart flamurin e proletariatit”.²⁷ Ndërsa në të tjera raste hasen shprehje si “shokun tonë të madh” ose “prijësin tonë më të ndritur”.²⁸ Ajo që bie në sy është se në zonat e kontrolluara nga njerëzit e “grupit të Hoxhës”, njëra ndër të cilat ishte p.sh. Liri Gega, “popullarizimi i komandantit” bëhej në mënyrë më sistematike. Vetë L. Gega tregon punën e madhe të bërë në këtë drejtim në një letër që i dërgoi Ramadan Çitakut, ku përmend edhe një këngë që qarkullonte, e cila fliste për “trimat e Enverit me ideal në gji/i kallin tmerr tmerrit”.²⁹ Nga vjeshta e vitit 1944, kulti i udhëheqësit të Enver Hoxhës filloi të lëshonte rrënjë në rreshtat e ushtrisë partizane. Duket sikur Enver Hoxha perceptohej si mishërimi i të gjithë udhëheqjes, pasi letrat përshëndetëse tashmë i dërgoheshin drejtpërdrejt atij dhe përmes tij komunikoheshin me drejtuesit e tjerë të Komitetit Qendror. Tanimë lëvdatat filluan të bëheshin më eksplicite. Në një letër nga Gjirokastra vihen në dukje se “puna e palodhur”, “vullneti i çeliktë”, “guximi shembullor” i Enver Hoxhës ishin faktorët që, siç thuhej në letër, “shtojnë gjithnjë e më shumë forcën e madhe t’organizatës s’onë për të qenë në krye t’aspiratave të popullit, për të qenë e denjë pararojë e luftës antifashiste nacionalçlirimtare të popullit t’onë”.³⁰ Jashtë strukturave ushtarake, burimet dokumentare janë tejet të mangëta, por disa tregues dëshmojnë se procesi dukej se nuk ecte me të

²⁶ *Po aty*, fl. 17. Përshëndetje e aktivit II të rinisë së qarkut të Elbasanit drejtuar KQ të PKSH-së, 26 tetor 1944.

²⁷ *Po aty*, fl. 14. Përshëndetje e aktivit të PKSH-së për qarkun e Vlorës, 24 shtator 1944.

²⁸ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1944, D. 125, fl. 4. Letër drejtuar Enver Hoxhës, sekretarit të Përgjithshëm të PKSH-së, nga aktivi i Brigadës VII Sulmuese, 13 shtator 1944.

²⁹ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1944, D. 93, fl. 6/2. Letër e Liri Gegës për Ramadan Çitakun, 7 korrik 1944.

³⁰ *Po aty*, F. 14/APL, V. 1944, D. 125, fl. 3. Letër drejtuar Enver Hoxhës, pas aktivit III të komitetit qarkor të PKSH-së për Gjirokastrën, 18 shtator 1944.

njëtin ritëm. Në një letër të dërguar në emër të popullit të Devollit, ku thuren disa lëvdata të kujdesshme për Enver Hoxhën, nuk ka firmat e banorëve, por vetëm atë të kryetarit të këshillit nacionalçlirimtar të zonës.³¹ Në një letër tjetër, letërshkruesi ngatërron terminologjinë e strukturave, duke iu drejtuar komitetit qendror nacionalçlirimtar, çka dëshmon konfuzionin dhe mungesën e njohjes së situatës.³²

Në labirintin e pushtetit: Kulti i Hoxhës në vitet e para të regjimit komunist

Në mbledhjen II të Këshillit Nacionalçlirimtar të mbajtur në Berat, Enver Hoxha caktohet kryetar i qeverisë së përkohshme, ministër i Luftës, si dhe në një sërë pozicionesh të tjera në Frontin dhe Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Ai po shndërrohej me shpejtësi në njeriun më të fuqishëm në Shqipëri. Por, një kthesë e ngjarjeve ngadalësoi fuqizimin e mëtejshëm të Hoxhës. Largimi i Miladin Popović-it dhe ardhja në Shqipëri e Misionit zyrtar jugosllav të përbërë nga Velimir Stojnić-i dhe Nijaz Džardarević-i, prishi ekuilibrat e krijuar në majën e strukturave drejtuese të PKSH-së. Nga gushti deri në nëntor 1944, ndërsa publikisht festoheshin fitoret e vazhdueshme të UNÇ-së dhe ngritja e strukturave qeverisëse të Frontit Nacionalçlirimtar, larg syve të publikut, PKSH-ja po kalonte krizën e parë të madhe të hierarkisë së saj drejtuese. Kjo krizë kulmoi me Plenumin II të KQ të PKSH-së, të mbajtur në Berat, ku u akuzua Byroja Politike e PKSH-së dhe, veçanërisht, Enver Hoxha për “vijën e gabuar politike” të ndjekur gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për sektarizmin e partisë dhe Frontit, për eliminimin e kundërshtarëve brenda partisë, si dhe për tendencat terroriste të strukturave politike dhe ushtarake të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.³³

Plenumi i Beratit tronditi seriozisht pozitën e Enver Hoxhës në krye të PKSH-së. Ai tregoi se një pjesë e kolegëve dhe e bashkëlufëtareve të tij nuk e shihnin si drejtuesin legjitim të partisë, por si një personazh të

³¹ *Po aty*, fl. 2. Letër drejtuar Enver Hoxhës nga këshilli nacionalçlirimtar i Devollit, 17 shtator 1944.

³² *Po aty*, F. 14/APL, V. 1944, D. 103, fl. 24. Telegram i këshillit nacionalçlirimtar të lagjes 7 (nuk përcaktohet qyteti) për KQ nacionalçlirimtar (sic!), pa datë.

³³ *Shih: Politikë antikomëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSH-së, Berat 23-27 nëntor 1944*, përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi (Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996).

imponuar. Gjatë mbledhjes u përdorën paralele mes ngritjes së kultit të Hoxhës dhe rritjes së autoritetit të Titos. Duket sikur në hierarkinë e lartë të PKSH-së kishte zënë rrënjë një kult individ i lidhur me Titon. Nuk ishin të paktë folësit që, duke krahasuar Hoxhën me Titon, theksuan legjitimitetin dhe autoritetin e udhëheqësit jugosllav. Në rastin e Titos, ishte puna, përpjekjet dhe idetë e tij që kishin bërë të mundur konsolidimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë. Në të kundërtën, Nako Spiru i kujtoi Hoxhës se ishin Miladin Popović-i dhe Dushan Mugosha në Panarit që kishin kërkuar ta lidhnin Lëvizjen me një emër të përveçëm dhe, sipas tij, iniciativa për ta “popullarizuar” Enver Hoxhën kishte qenë e Liri Gegës.³⁴ Sejfulla Malëshova iu kundërvu haptazi legjitimitetit të Hoxhës në krye të PKSH-së, duke thënë se të qenët sekretar politik nuk do të thoshte automatikisht se je kryetar i partisë, pasi “kreu dhe kryetarët e një lëvizjeje nuk bëhen me dekret, ata i nxjerr lufta”.³⁵ Tuk Jakova vuri në dukje se “popullarizimi” i imponuar nuk kishte prodhuar mbështetje reale për Hoxhën, qoftë edhe në radhët e UNÇ-së, pasi partizanët nuk e njihnin fare atë.

Ajo që thoshte Jakova nuk ishte tërësisht e saktë. Pavarësisht përplasjeve të brendshme, procesi fillestar i ndërtimit të kultit kishte bërë punën e vet. Në të vërtetë, ishin pikërisht rrethanat historike, të kombinuara me aftësinë e Hoxhës për t’u shfaqur i përlur kur e kërkonte situata, dhe shpërndarja e fajit te bashkëpunëtorët e tij, disa nga faktorët që i siguruan Enver Hoxhës qenien në krye të hierarkisë shtetërore dhe partiake. Qeveria e përkohshme duhej të udhëtonte për të bërë hyrjen triumfale në Tiranë më 28 nëntor 1944. Ushtria dhe popullsia duhej të njiheshin personalisht me njeriun për të cilin ishte folur aq shumë përgjatë gjashtë muajve të fundit.

Në atë moment filloi të shfaqej një hendek midis ngritjes së kultit të Hoxhës në sytë e publikut të gjerë dhe autoritetit që ai gëzonte brenda hierarkisë së lartë partiake dhe shtetërore. Ndërsa goditi Hoxhën, Berati nuk eidentoi ndonjë figurë tjetër drejtuesi të gjithëpranuar. Përkundrazi, ai krijoi në hierarkinë drejtuese të PKSH-së, një lloj *quadrumvirati* midis Enver Hoxhës, Koçi Xoxes, Nako Spirit dhe Sejfulla Malëshovës – të katërt me sferën e tyre të ndikimit brenda partisë dhe autoriteteve

³⁴ “Nga fjala e Nako Spirit në Plenumin II të KQ të PKSH-së në Berat (23-27 nëntor 1944)”, në *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës*, 122.

³⁵ “Nga fjala e Sejfulla Malëshovës në Plenumin II të KQ të PKSH-së në Berat (23-27 nëntor 1944)”, në *Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës*, 130.

qeverisëse, të katërt ambiciozë, të katër relativisht të njohur brenda radhëve të anëtarëve dhe aktivistëve të LNÇ-së, por pa ndonjë njohje solide në shoqërinë shqiptare.

Ndër të katërt, përparësia e Enver Hoxhës lidhej me pozicionet politike dhe shtetërore që ai zotëronte. Për sa kohë partia vepronte në gjysmilegealit, ai tregonte pak interes ndaj saj, duke ia lënë përgjegjësinë sekretarit organizativ, Koçi Xoxes.³⁶ Qenia e tij njëkohësisht kryeministër, kryetar i Frontit Demokratik, komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare/Popullore, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor etj. e bënte atë të kudogjendur, duke u lejuar propagandistëve të vijonin procesin e ndërtimit të kultit të tij të individit. Pavarësisht se Enver Hoxhës i mungonin shkollimi marksist-leninist dhe përvoja e Malëshovës në BRSS, si edhe eksperiencia revolucionare e Koçi Xoxes, Pandi Kristos, Bedri Spahiut, madje nuk shfaqte as këmbënguljen e vullnetin për punë të Nako Spirut, ai ishte njeriu që publiku e shihte më së shumti në foltoret dhe podiumet e mitingjeve, ose e dëgjonte përmes altoparlantëve të instaluar në çdo qendër kryesore banimi. Pas largimit të Liri Gegës nga organet drejtuese, rolin e propaganduesit të Hoxhës e morën ish-kundërshtari i tij në Plenumin e Beratit, Nako Spiru, dhe Fadil Paçrami, drejtuesi i sektorit të propagandës në Komitetin Qendror.

Gjatë vitit 1946, Nako Spiru dërgoi disa urdhra për komitetet qarkore të PKS-së, në të-cilët u kërkonte të dëgjonin dhe të analizonin fjalimet e Enver Hoxhës, si kryeministër dhe si kryetar i Frontit. Ai kërkonte të popullarizohej intervista e tij në lidhje me pretendimet greke, së bashku me intervistën e Stalinit dhe disa artikuj mbi Jugosllavinë; fjalimi i tij në Kuvendin Popullor me rastin e votëbesimit të qeverisë së re; vizita e Enver Hoxhës në Jugosllavi etj. Në disa raste, siç ishte fjalimi i Enver Hoxhës në Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Demokratik më 7 prill 1946, Spiru urdhëronte të mblidhnin popullin para altoparlantëve për të dëgjuar këtë fjalim. Sërish, më 30 dhjetor 1946, Nako Spiru dërgon një telegram urgjent për të gjitha komitetet e qarqeve, ku udhëzonte se si duhej “popullarizuar” mesazhi i “komandantit” me rastin e Vitit të Ri. “Me anë të agjitacionit të popullarizohet që sot dhe në mënyrë që ky mesazh të dëgjohej nga të gjithë pa përjashtim, kudo që të jenë në familje

³⁶ “Raport nga përfaqësuesi i KQ të PKJ-së, Savo Zllatiq, mbi takimin me Enver Hoxhën, 13 shtator 1946”, në *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, vëll. I, përgatiti për botim Sabit Sylja dhe Qerim Lita (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020), 328.

apo në klube. Dëgjimi të organizohet veçanërisht në vendet e grumbullimit ku njerëzit janë mbledhur për të festuar Vitin e Ri, të dëgjohet në familje që kanë radio, ku të jenë thirrur dhe njerëz të lagjes, të vihen altoparlantë nëpër rrugët etj. Pas fjalimit duhet të bëhej një popullarizim i gjerë i mesazhit të komandantit”.³⁷ Në sytë e shqiptarëve, me një traditë politike absolutiste dhe autoritariste, ai mëshironte shtetin, me të cilin nuk mund të luhej.

Gradualisht, Enver Hoxha filloi të propagandohej jo thjesht si një drejtues politik dhe shtetëror, por edhe si një ideolog. Pavarësisht se edukimi ideologjik i Hoxhës ishte ende një punë në progres, Fadil Paçrami filloi ta vendoste atë në të njëjtin rang me mendimtarët e marksizëm-leninizmit. Savo Svllatić, këshilltari i Partisë Komuniste Jugosllave (PKJ) pranë PKSH-së, vë në dukje se veçanërisht pas vitit 1947 “rrethi i tij e ngre Hoxhën në atë nivel që i kalon kufijtë e modestisë. Në gazeta e krahasojnë me Marks, Leninin e Stalinin dhe në rrugë ka citate se çfarë thotë Lenini për një çështje të caktuar dhe çfarë thotë Enveri”.³⁸

Enver Hoxha, gjithsesi kishte përparësi që u mungonin rivalëve të tij: ai dinte të aktronte shumë bukur. Edhe pse në rrethet e ngushta të bashkëpunëtorëve kishte reputacionin e një njeriu nevrrik, jo të durueshëm³⁹ dhe jo shumë social, ai dinte të ishte karizmatik aty kur duhej. Falë paraqitjes së tij në publik si një njeri energjik, relativisht i ri në moshë, me një buzëqeshje që nuk mungonte kurrë të cilën e përdorte me mjaft mjeshtëri, shtatlartë dhe mjaft i pashëm, fushata e mirëmenduar për “të popullarizuar komandantin” e shndërroi atë në personazhin politik më të njohur në vend. Ai mund të mos kishte besimin dhe mbështetjen e të gjithë kolegëve, por gjithnjë e më shumë filloi të fitonte zemrat e publikut. Në vitin 1946, ministri fuqiptotë jugosllav Gjergja pranoi se popullariteti i Enver Hoxhës nuk ishte aq i madh sa besohej në

³⁷ *AQSH*, F. 14/APSTR., D. 131/2, fl. 5. Radiogram (tepër urgjent) drejtuar të gjitha komisioneve të agit-propit në të gjitha qarqet.

³⁸ *Shih*: “Raportet për marrëdhëniet me Jugosllavinë gjatë vitit 1947”, në Sylja, Lita (përg.) *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, 525-526.

³⁹ Në letrën që Liri Gega i dërgonte nga Veriu Ramadan Çitakut i shkruante “Por kur mendoj Enverin me shumë punë, të okupuar ditë e natë, disa herë të bëhet nervoz e i ashpër me të gjithë”. Mustafa Kaçaçi, i cili përshëndeste Ramadan Çitakun, në të njëjtën letër e porosiste të mos e linte Enver Hoxhën të fliste kur ishte i nxehur dhe t’i kërkonte të “përdori gjithmonë butsin dhe urtësin t’ande”. *AQSH*, F. 14/APL, V. 1944, D. 93, fl. 6/2. Letër e Liri Gegës për Ramadan Çitakun, 7 korrik 1944.

Jugosllavi.⁴⁰ Megjithatë, dy vjet më vonë, edhe vetë jugosllavët duhej të pranonin se Hoxha kishte fituar mbështetje në popull. Në nëntor 1947, gjatë vizitave të tij në disa krahina të Jugut, Hoxha shprehet shumë i kënaqur për entuziazmin e popullit për “partinë, pushtetit dhe udhëheqësit”. Gjatë një mbledhjeje të Byrosë Politike, Mehmet Shehu dhe Enver Hoxha shkëmbyen disa batuta për këngët që këndoheshin më shumë në Vlorë sesa në Kurvelesh.⁴¹

Enver Hoxha tregoi se kishte pragmatizëm dhe intuitë të veçantë për të lundruar në korridoret e pushtetit, çka i mundësoi jo vetëm të mbijetonte, por edhe të forconte pas çdo sulmi autoritetin e tij. Midis viteve 1944-1948, Hoxha as nuk kishte vendosur autoritetin e tij absolut brenda PKSH-së, por, ç’është më e keqja, nuk gëzonte mbështetje as në planin ndërkombëtar. Ai ishte i vetmi ndër drejtuesit e partive komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore që nuk kishte asnjë kontakt personal me Moskën, me Kominternin apo me strukturat e tij të mbetura. Edhe me Josip Broz Titon, kreun e PKJ-së, mbi modelin, përvojën dhe këshillat e të cilit u bazua i gjithë rrugëtimi i PKSH-së, Hoxha nuk kishte pasur kontakt personal deri në qershor-korrik të vitit 1946. Prejardhja e tij familjare, edukimi i tij frankofon dhe mungesa e përgatitjes ideologjike nuk e bënë atë kandidatin më të pëlqyer, as për Beogradin, as për Moskën, për të qenë në krye të një partie bolshevike.⁴²

Enver Hoxha ishte i vetëdijshëm për pozitat sfiduese të autoritetit të tij. Jugosllavia qartazi luante me rivalitetet e brendshme të PKSH-së. Për nënshkrimin e Konventës Ekonomike u ftuan në Beograd N. Spiru dhe K. Xoxe, gjë që shkaktoi reagimin e Hoxhës. Ai i shprehu shqetësimin e tij

⁴⁰ “Ministri jugosllav në Tiranë, Josip Gjergja për Beogradin”, në Sylja, Lita (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, I, 285.

⁴¹ *AQSH*, F. 14/APOU, V. 1947, D. 28. Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 21 tetor 1947.

⁴² Norman M. Naimark-u sjell bisedën mes Edward Kardelj-it dhe Stalinit në prill 1947. Kardelj-i pranonte se Hoxha kishte influencë në popull, por i mungonte përgatitja marksiste-leniniste, gjë që jo vetëm miratohej, por edhe përforcohej nga Molotovi, i cili shprehej se në formimin e tij “ndihej influenca perëndimore”. Naimark-u ka të drejtë kur pohon se, në këndvështrimin sovjetik, këto ishin “akuza shkatërruese” dhe tregonin se Kardelj-i, por dhe Moska, mund të kishin qenë të gatshëm ta zëvendësonin Hoxhën me Xoxen, si sekretar të Përgjithshëm të PKSH-së. *Shih*: Norman M. Naimark, *Stalin and the fate of Europe, The postwar struggle for sovereignty* (London England, Cambridge, Massachusetts: The Belknap Press of Harvard University Press, 2019), 63.

ministrit jugosllav në Tiranë, Gjergja, duke theksuar se ishte vetëm formalisht në krye të PKSH-së.⁴³ Më herët, këtë shqetësim Hoxha ua kishte bërë të ditur edhe anëtarëve të Byrosë Politike.⁴⁴

Pavarësisht kësaj, midis viteve 1944-1948, Hoxha shfrytëzoi me kujdes të gjitha rrethanat që i siguruan qëndrimin e sigurt në majën e piramidës partiake dhe shtetërore. Duke e parë veten ende të pafuqishëm në krye të PKSH-së, ai shfrytëzoi me kujdes edhe rivalitetet e brendshme. Pas rezultatit surprizë të zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945,⁴⁵ ai u pozicionua në një front me Nako Spirun dhe Koçi Xoxen – të nxitur edhe nga jugosllavët – për të larguar Sejfulla Malëshovën nga strukturat drejtuese partiake.⁴⁶ Në Plenumin e KQ të PKSH-së në shkurt 1946, Hoxha kishte arritur të neutralizonte edhe dy mbështetësit e Malëshovës, Bedri Spahiun dhe Tuk Jakovën, të cilët e kishin sulmuar ashpër në Plenumin e Beratit. Qenia e tyre në Byronë Politike deri më 1948 ishte praktikisht fiktive, madje të dy kishin kërkuar largimin e tyre prej saj. Me kërkesën e jugosllavëve, vendimet e Plenumit V nuk u bënë publike për anëtarësinë e PKSH-së deri në maj të vitit 1947,⁴⁷ kohë kur filluan spastrimet në Kuvendin Popullor me arrestimin e deputetëve që ishin zgjedhur në të për shkak të politikës së zgjerimit të Frontit.

Pas largimit të Malëshovës dhe, veçanërisht, pas pranimit nga ana e Titos të kërkesës për të vizituar Beogradin, u duk se autoriteti i Hoxhës brenda hierarkisë së lartë të partisë filloi të konsolidohej. Pritja në Beograd, dekorimi i tij atje ishte një lloj legjitimimi i pozicionit të tij në

⁴³ “Raport i Savo Sllatiçit për KQ të PKJ, 20 shkurt 1947”, në Syla, Lita (përg.) *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, 428.

⁴⁴ “Pas Beratit, Partia s’kishte sekretar politik real”, u shkruan Enver Hoxha kolegëve të tij të Byrosë Politike në qershor 1946. *AQSH*, F. 14/APOU, V. 1946, D. 9. Teza të paraqitura nga Enver Hoxha për rishikimin e tezave të Plenumit të Beratit.

⁴⁵ Në lidhje me zgjedhjet për Asamblenë Kombëtare të 2 dhjetorit 1945, *shih*: Sonila Boçi, “The December 2nd, 1945 Albanian Elections: Legalization, or mere formalization for Communist Power”, In *Porta Balkanica* vol. 7, iss. 2 (2015): 16-19.

⁴⁶ *AQSH*, F. 14/AP-OU, V. 1946, D. 1/1. Procesverbal i Plenumit V të KQ të PKSH-së, 21 shkurt 1946.

⁴⁷ Sipas një komunikimi të Aleksandar Ranković-it me Koçi Xoxen, Plenumi V i KQ të PKSH-së kishte shkuar shumë larg me vendimin për të hedhur “bazat e socializmit”, çka prekte thelbin e akuzave ndaj Malëshovës. Ai e këshilloi Xoxen që të mos i bënin publike punimet e tij. *Shih*: “Radiogram dërguar nga Beogradit (Nesti Kerenxhi) për Koçi Xoxen, Beograd, 29 mars 1946”, në *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948)*, përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi (Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996), 29.

krye të partisë. Duke i konsideruar vendimet e Plenumit të Beratit si thembrën e Akilit për autoritetin e tij, në qershor 1946, pak para udhëtimit në Jugosllavi, Hoxha, në bashkëpunim me Nako Spirun, bëri një përpjekje për të rishikuar “tezat e Plenumit të Beratit”, pra për të rehabilituar veten dhe pozicionin e tij në krye të partisë. Në materialin që i paraqiti KQ të PKSH-së, Hoxha kërkonte ta paraqiste atë çka ndodhi në Berat, si një gabim “pa dashje” të Velimir Stoinić-it. Ai, përveç të tjerave, donte t’u bënte të kuptonin bashkëpunëtorëve të tij se rezistenca ishte baza e legjitimitetit të pushtetit të tyre dhe se në Berat ajo ishte goditur. Me drejtësinë e “vijës politike”, ai kërkonte të rifitonte autoritetin e tij të lëkundur nga Plenumi i Beratit. Nëse me këtë kërkesë Hoxha donte të maste pulsin dhe të testonte fuqinë e autoritetit të tij, ai shpejt kuptoi se nuk ishte ende aq i fuqishëm për të bërë këtë lëvizje dhe u tërhoq.⁴⁸ Dokumentet jugosllave flasin edhe për një përpjekje të Enver Hoxhës menjëherë pas kthimit të tij nga Beogradi, për të larguar Koçi Xoxen, gjë që, sipas tyre, e afroi këtë të fundit me legatën jugosllave.⁴⁹ Kur kjo manovër nuk pati rezultat, Hoxha zgjodhi të merrte rolin e arbitrit në konfliktet e vazhdueshme midis Xoxes dhe Spirit, pavarësisht se, sipas jugosllavëve, favorizonte haptas Spirun.⁵⁰

Fakti që autoriteti i tij nuk ishte ende ai i një lideri stalinist shpjegohet edhe nga lëvizja që ndërmoi në vjeshtën e 1946-s. Kur kuptoi se mbështetja në Byronë Politike nuk ishte në favor të tij, u përpoq të konsolidonte autoritetin përmes përfshirjes së individëve besnikë në hierarkinë e lartë drejtuese të PKSH-së. Ndonëse hasi në rezistencën e jugosllavëve, ai arriti të bënte menjëherë gjashtë kooptime në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror.⁵¹ Kjo lëvizje bazohej në traditën

⁴⁸ *AQSH*, F. 14/APOU, V. 1946, D. 9. Enver Hoxha: Tezat mbi revizionimin e Plenumit të Beratit (qershor 1946).

⁴⁹ “Raport mbi situatën politike në Shqipëri, hartuar më 23 korrik 1946, nga legata jugosllave në Tiranë, nr. 84”, në Sylja, Lita (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, I, 283-299.

⁵⁰ “Raport i Savo Zllatić-it për KQ të PKJ, 9 dhjetor 1946”, në *po aty*, 431.

⁵¹ Në vjeshtën e vitit 1946, Hoxha i kërkoi përfaqësuesit jugosllav pranë KQ të PKSH-së, Savo Zllatić, të kooptonin gjashtë veta në Byronë Politike, me argumentin se konflikti midis Koçi Xoxes dhe Nako Spirit e kishte bërë atë jofunksionale. Midis emrave që propozonte Hoxha ishin: Liri Belishova, drejtuesja e Rinisë Komuniste, Mehmet Shehu, shef i Shtatmadhorisë dhe Fadil Paçrami, ministër i Arsimit dhe drejtues i propagandës në KQ të PKSH-së, të cilët nuk ishin të pëlqyeshëm për jugosllavët. Me miratimin e jugosllavëve u kooptuan në Byronë Politike: Hysni Kapo,

politike shqiptare të sigurimit të ndikimit dhe nuk kishte lidhje me ndonjë luftë ideologjike.

Në gjysmën e parë të vitit 1947, kur u bë e qartë se zbatimi i Konventës Ekonomike do të thoshte humbje e sovranitetit dhe e pavarësisë së Shqipërisë dhe, kur mosbesimi i trashëguar ndaj sllavëve filloi të shfaqej si një pakënaqësi në rritje ndaj arrogancës së këshilltarëve jugosllavë në Shqipëri, Enver Hoxha mbështeti projektin prosovjetik të Spirut dhe të dy bashkë këmbëngulën në kërkesën e tyre që Hoxha të zhvillonte një vizitë zyrtare në BS.⁵² Vizita, për të cilën Nako Spiru kishte punuar shumë për ta realizuar, ishte edhe fillimi i fundit të tij. Lajmi për vajtjen e një delegacioni shqiptar në Moskë shkaktoi reagimin e menjëhershëm jugosllav, të cilët kuptuan se drejtuesit e PKS-së po përpiqeshin të shkëputeshin nga varësia e Beogradit për t'u lidhur drejtpërdrejt me Moskën. Ata akuzuan udhëheqjen shqiptare për lejimin e “një vije të dytë antijugosllave”.

Para udhëtimit në Moskë, Hoxha dhe Byroja Politike i hodhën poshtë këto akuza,⁵³ por takimi me Stalinin dhe me udhëheqës të tjerë sovjetikë (korrik 1947) nuk shkoi tërësisht sipas pritshmërive të Hoxhës. Pritja ishte shumë miqësore dhe, për publikun e gjerë, si edhe për rrethin e afërt të bashkëpunëtorëve, u shfrytëzua me kujdes si një tjetër legjitimim i autoritetit të tij. Megjithatë, vizita nuk e shpëtoi as Hoxhën dhe as Shqipërinë nga ndikimi dhe kontrolli jugosllav. Në Moskë, Hoxhës iu përsërit qëndrimi që Molotovi ia kishte përmendur që në gusht 1946 në Paris, se “rruga e Shqipërisë për në Moskë kalon nga

ish-ministri shqiptar në Beograd, Kristo Themelko, kreu i Drejtorisë Politike në Ushtrinë Kombëtare dhe Gogo Nushi, kreu i sindikatave, ndërsa tre të tjerët u kooptuan si anëtarë të Komitetit Qendror. Pavarësisht se jozyrtarisht anëtarë të Byrosë Politike, tri propozimet e para, të konsideruar “miq të Byrosë Politike” ftoheshin vazhdimisht në mbledhjet e saj, duke krijuar një bazë mbështetëse për Hoxhën. (*Shih*: “Relacion i Savo Zlatic-it për KQ të PKJ-së rreth bisedës së tij me Enver Hoxhën mbi ndryshimet në përbërjen e KQ të PKS-së, 7 tetor 1946”, në Syla, Lita (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, I, 344).

⁵² Më 27 prill-27 maj 1947, Nako Spiru vizitoi Bashkimin Sovjetik në krye të një delegacioni të shoqatës së miqësisë. Gjatë kësaj vizite, ai siguroi aprovimin e sovjetikëve për një vizitë të Enver Hoxhës atje. *Shih*: *AQSH*, F. 14/APOU, V. 1947, D. 16, fl. 2. Raportim i Nako Spirut para Byrosë Politike mbi vizitën e tij në BRSS, 27 maj 1947.

⁵³ *Po aty*, F. 14/APOU, V. 1947, D. 20. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKS-së, 1 korrik 1947.

Beogradi”.⁵⁴ Fakti që ministri sovjetik në Tiranë, Dimitri Chuvahin, i cili shoqëronte Hoxhën gjatë këtij udhëtimi, u mbajt në Moskë dhe nuk u ridërgua në Tiranë për një kohë të gjatë, ishte një tjetër kampion alarmi për autoritetin e tij.

Në shtator 1947, Zllatic-i përsëriti akuzën për një vijë të dytë antijugosllave në gjirin e KQ të PKSH-së. Tanimë akuza ishte adresuar tek emra të përveçëm, më kryesori ndër të cilët ishte Nako Spiru. Në këto akuza për antijugosllavizëm dhe si agjent i imperializmit,⁵⁵ Hoxha kuptoi furtunën që po afrohej: sulmi indirekt shigjetonte atë vetë dhe frymën intelektualiste që ai përfaqësonte. Por Hoxha kuptoi gjithashtu se jugosllavët i kishin ofruar një barkë shpëtimi. Në akuzë nuk ishte “vija politike” për të cilën ai mbante përgjegjësi personale, por disa individë që nuk e kishin ndjekur atë. Jo pa mëdyshje, Hoxha zgjodhi ta tradhtonte ish-aleatin e tij brenda Byrosë dhe ta sulmonte ashpër.⁵⁶ Vetëvraska e Nakos u shërbeu kundërshtarëve të tij si vërtetim i akuzave të ngritura kundër tij.

Pavarësisht se iu bashkua korit të akuzuesve, Enver Hoxha nuk mundi të shpëtonte plotësisht nga kritikata. Mbledhjet e Byrosë Politike, që zgjatën gati dy muaj, vunë në dukje se “intelektualizmi” i Spirit s’ bashku me prejardhjen e tij shoqërore u etiketuan si thelbi i “tradhtisë” së tij, çka ishte një goditje e tërthortë edhe për edukimin dhe prejardhjen shoqërore të Hoxhës. Por Hoxha dinte ta ulte kokën dhe të shfaqej tejet modest dhe i përlulur kur ia donte puna. Ai e dinte se gurët lëvizeshin nga jugosllavët, të cilët qartazi favorizonin elementin proletar dhe kishin shprehur hapur mospëlqimin për përbërjen “intelektuale” të Komitetit Qendror të PKSH-së. Ajo që mund të bënte Hoxha në atë moment ishte të fitonte kohë: nga njëra anë, ai fajësoi Nako Spirun dhe mbështetësit e tij

⁵⁴ *Po aty*, F. 14/APOU, V. 1947, D. 1. Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, ku është diskutuar vizita e Enver Hoxhës në Moskë dhe takimi me Stalinin.

⁵⁵ “Raport i Savo Zllatic-it për KQ të PKJ-së, 9 nëntor 1947”, në Sylja, Lita (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, I, 493.

⁵⁶ Gjatë takimit të Hoxhës dhe Xoxes me Zllatic-in, Hoxha kërkoi të sigurohej se akuzat e komunistit jugosllav pasqyronin mendimin e Titos dhe të KQ të PKJ-së. Ai i kujtoi bashkëbiseduesit se opinionet personale të përfaqësuesve jugosllavë e kishin vënë dy herë në vështirësi PKSH-në: një herë në Berat dhe një herë tjetër në dhjetor-shkurt 1946. Përpara se të fillonte një spastrim të tretë në parti në më pak se tre vjet, ai donte të sigurohej se ky ishte mendimi i rangjeve më të larta të PKJ-së. *Shih*: “Raport i Savo Zllatic-it për KQ të PKJ-së, 9 nëntor 1947”, në Sylja, Lita (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, I, 493.

në Komitetin Qendror – Mehmet Shehun, Liri Belishovën, Fadil Paçramin etj. – “për zbatim të gabuar të vijës”; nga ana tjetër, bëri autokritikë për mungesë vigjilence dhe për “rënie nën ndikimin e Nakos”. Me shtimin e presionit jugosllav për federimin e Shqipërisë në Jugosllavi, Hoxha shfaqet më i bindur dhe bashkëpunues. Zllatić-i shprehej shumë i kënaqur nga bashkëpunimi me Hoxhën dhe Xoxen, të cilët i praninin propozimet e tij, “Enveri, thujse pa asnjë kundërshtim, ndërsa Koçi jep kundërpropozime dhe i shtron mendimet e veta”.⁵⁷

Kur e pa veten pa rrugëdalje, midis sovranitetit e pavarësisë së Shqipërisë dhe pushtetit të tij, Hoxha qartazi zgjodhi këtë të fundit, madje duke shkuar edhe më larg se gjithë të tjerët, të cilët më vonë u akuzuan për projugosllavë, duke propozuar që jo vetëm ekonomia, kultura e ushtria të organizoheshin në baza federative me Jugosllavinë, por edhe vetë strukturimi i PKSH-së. Ai deklaroi se, në të vërtetë, Titoja ishte sekretar i Përgjithshëm i partisë, ndërsa ai vetë dhe Xoxe ishin thjesht sekretarë republikash.⁵⁸ Ishte Xoxe që bëri thirrje për të qenë të kujdesshëm në deklarata të tilla, pasi kjo nuk ishte në dorën e komunistëve shqiptarë, por në atë “të Stalinit dhe kampit antiimperialist”.⁵⁹

Në prag të konfliktit Tito-Stalin, pozita e Hoxhës ishte vërtet e vështirë. Mbledhjet e Byrosë Politike të dhjetor-janarit 1947-1948 dhe Plenumi VII i KQ të PKSH-së, i mbajtur në shkurt 1948, ishin pothuajse një *dejá vu* e Plenumit II të Beratit. Gabimet e bëra gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare u hodhën sërish në tavolinë, së bashku me ato të evidentuara në drejtimin e partisë gjatë viteve të pasçlirimit. Edhe pse tonet ishin më të kontrolluara, ai u akuzua se kishte mbështetur ambiciet e Nako Spirut dhe “fraksionit” të tij, gjë që kishte ndihmuar në formësimin e një vije antijugosllave.⁶⁰

⁵⁷ “Raport nga Savo Zllatić-i dërguar KQ të PKJ-së në lidhje me çështjet aktuale të PK të Shqipërisë, 18 janar 1948”, në *po aty*, 543.

⁵⁸ “Mbledhja e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 5 janar 1948...”, në Plasari, Malltezi (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948)*, 169.

⁵⁹ “Mbledhje e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së rreth marrëdhënieve me PKJ-në, 22 janar 1948”, në *po aty*, 200-201.

⁶⁰ Kështu, p.sh., në një nga fjalimet u përmend se Fadil Paçrami, i cili ishte përgjegjës për propagandën i përligjite veprimet e veta duke përmendur emrin e Komandantit [Enver Hoxhës].

Gjatë mbledhjeve të Byrosë, Hoxha u akuzua se kishte lejuar të ngrihej rreth tij një kult individit i pamerituar, duke eklipsuar të tjerët.⁶¹ Por, ndërsa pranoi me përlësi akuzat, Hoxha zgjodhi edhe të kundërsulmonte, duke mos bërë dallimin midis reputacionit natyral të personazheve publike dhe ndërtimit të kultit të tij. Kështu, ai konsideronte si ndërtim kultit faktin që Shefqet Peçi mbante në zyrë vetëm foton e Bedri Spahiut, të cilin e kishte mik dhe kishin ndarë së bashku vite të gjata luftimesh.⁶² Nëse kjo ishte mënyra e Hoxhës për të fajësuar Bedri Spahiun se nuk kishte luftuar kundër të ashtuquajturit “kultit të tij”, apo për të theksuar para të pranishmëve se kultit krijohet pavarësisht nga dëshira e individit, është e vështirë të thuhet. Me shumë gjasa, Hoxha donte të vriste me një gur dy zogj.

Popullariteti që kishte siguruar, edhe falë propagandës së drejtuar nga ata që akuzonte, i mundësoi Hoxhës të qëndronte sërish në krye të PKSH-së; megjithatë, muajt pas Plenumit të shkurtit ishin, ndoshta, më të vështirë për të. Jugosllavët nxisnin drejtuesit e PKSH-së për t'u bërë ata iniciatorët e kërkesës për bashkimin e Shqipërisë me Federatën Jugosllave; ndërkohë, nga Bullgaria vinin njoftime se në qershor do të shpallej një federatë mes Bullgarisë dhe Jugosllavisë, ndërsa sovjetikët kërkonin të testonin nga anonte besnikëria e shqiptarëve. E gjithë kjo lojë e madhe ishte e vështirë për liderin pa përvojë të PKSH-së. Ai kishte treguar edhe më herët se gjithmonë zgjidhte më të fortin, por më i forti i kishte thënë qartë, më se një herë se Shqipëria duhej të forconte lidhjet me Jugosllavinë.

Gjithsesi, kur Hoxha u përball me situatën në të cilën duhej të firmoste kërkesën për humbjen e pavarësisë dhe të sovranitetit, në fillim ishte konfuz, pastaj hezitues dhe, në fund, vendosi – siç kishte bërë gjithmonë – t'ia linte kohës. Në disa mbledhje të Byrosë Politike u diskutua nëse duhej vënë në dijeni Bashkimi Sovjetik për bashkimin e pritshëm të Shqipërisë me Jugosllavinë. Hoxha, të cilit sapo i kishin bërë një dush të mirë për mbështetjen e “qëndrimeve antijugosllave të Nako Spirut”, pikërisht sepse ishte përpjekur të lidhej drejtpërdrejt me BRSS-në, nuk donte të rizgjonte zemërimin e Titos. “Ne me jugosllavët do të kemi shumë bisedime dhe propozime, – u thoshte ai anëtarëve të tjerë të

⁶¹ “Fjala e Koçi Xoxës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së rreth marrëdhënieve me PKJ-në, 8 janar 1948”, në *po aty*, 180.

⁶² “Nga fjala e Enver Hoxhës në mbledhje të Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 5 janar 1948”, në *po aty*, 170.

Byrosë Politike, – deri sa të mos kemi përfunduar gjë, ne të mos u themi asgjë sovjetikëve”. Në fund të fundit, federata nuk ishte ide e Shqipërisë; si rrjedhojë nuk i takonte asaj të lajmëronte drejtuesin e Kampit.⁶³

Koha foli në favor të Enver Hoxhës, por edhe të sovranitetit të Shqipërisë. Ndërsa në Shqipëri po punohej me anëtarët e PKSH-së rezolucioni i Plenumit VIII të KQ të PKSH-së, konflikti Stalin - Tito u përshkallëzua. Ministri sovjetik në Tiranë, Chuvahin, njoftoi Hoxhën për letrën që Stalini i kishte dërguar Titos që nga fillimi i prillit 1948, por Hoxha nuk i vuri menjëherë në dijeni anëtarët e Byrosë Politike.⁶⁴ Gjatë prillit 1948, partitë komuniste në Perëndim dhe në Lindje filluan të shprehnin mbështetjen e tyre ndaj kritikave të Stalinit, ndërsa PKSH-ja ende nuk kishte marrë asnjë qëndrim. Kjo situatë vazhdoi deri më 23 prill, kur Enver Hoxha më në fund e diskutoi në Byronë Politike, si bisedën me Chuvahin-in, ashtu edhe letrën e Stalinit kundër Titos.⁶⁵

Pavarësisht kësaj, ai kishte filluar të merrte një kthesë të kujdesshme. Pa marrë një qëndrim të prerë kundër Jugosllavisë, u përpoq

⁶³ “Nga fjala e Enver Hoxhës në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, 30 mars 1948”, në *po aty*, 435.

⁶⁴ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. V (1945-1999), drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, grup autorësh, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2023), 265.

⁶⁵ Koha kur Enver Hoxha është vënë në dijeni për letrën e Stalinit është e vështirë për t’u përcaktuar, ndërsa datimi i saj i saktë do të na ndihmonte për të kuptuar më mirë lëvizjet e tij politike. Në përmbledhjen me dokumente mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, përgatitësit e saj Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi mendojnë se Hoxha u njoh me letrën e Stalinit më 15 prill 1948. Në kujtimet e veta, Enver Hoxha është evaziv për kohën kur është vënë në dijeni për letrën, por thotë se në takim ishte me Hysni Kapon duke qenë se Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo ishin nëpër aktivet e PKSH-së në rrethe për të diskutuar rezolucionin e Plenumit VIII. Studiuesja Ana Lalaj mendon se letra i është dorëzuar Enver Hoxhës në fund të marsit dhe në fillim të prillit 1948. Duke u nisur nga të dhënat që kemi në dispozicion, mendoj se konstatimi i prof. Lalaj është më i saktë. *Së pari*, nëse Koçi Xoxe ka qenë në rrethe kur është dorëzuar letra, atëherë më 30 mars, ai është kthyer, pasi është zhvilluar një mbledhje e Byrosë Politike pikërisht për të diskutuar rezultatet e punimit të Rezolucionit të Plenumit VIII të KQ të PKSH-së në qarqe. *Së dyti*, vërehet një kthesë shumë e kujdesshme në qëndrimet e Hoxhës kundrejt jugosllavëve. Një prej shembujve është ndryshimi i qëndrimit të tij në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së më 10 prill. Në të, ndryshe nga një mbledhje më parë, Hoxha shpreh mendimin për të njoftuar sovjetikët për propozimet e jugosllavëve, gjë që të bën të dyshosh se ai ishte në dijeni të konfliktit që sapo kishte lindur midis Titos dhe Stalinit. N. Plasari, L. Malltezi (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948)*, 14.

të jepte sinjale besnikërie ndaj Bashkimit Sovjetik. Kjo ishte fryma që përshkroi edhe mbledhjen e Byrosë Politike më 25 prill. Megjithatë, në gjuhën revolucionare, qëndrimi i Hoxhës quhej oportunizëm, dhe ministri fuqiplotë sovjetik ia bëri të qartë atij se, nëse nuk do të mbante një qëndrim të prerë, këshilltarët sovjetikë do të largoheshin nga Shqipëria.⁶⁶ Enver Hoxha personalisht nuk kishte asnjë arsye të mbështeste jugosllavët. Ai, edhe më herët, ishte përpjekur ta çlironte veten nga përqafimi mbytës i tyre. Kështu, besoj se Hoxha ka qenë i sinqertë kur shkruante se letrat e Stalinit të majit 1948 ishin “shpëtimtare”.⁶⁷ U shpëtua pavarësia e Shqipërisë, por u krijua gjithashtu mundësia për të konsoliduar autoritetin e tij, duke goditur rivalët në udhëheqje.

Gjithsesi, Enver Hoxhës iu deshën më shumë se katër muaj për të qartësuar qëndrimin e PKSH-së ndaj konfliktit Stalin - Tito, si dhe për të përgatitur goditjen kundër Koçi Xoxes dhe mbështetësve të tij. Duket se pas takimit *incognito* të Enver Hoxhës me kryeprokurorin sovjetik Andrei Vyshinski, filloi kthesa e vërtetë e PKSH-së.⁶⁸ Përse kaq kohë, kur të gjitha partitë si motra ishin treguar më të qarta në qëndrimet e tyre?⁶⁹ Kësaj pyetjeje është e vështirë t’i jepet një përgjigje shteruese me njohjen e deritanishme të burimeve. Ndryshe nga partitë e tjera komuniste të

⁶⁶ *AQSH*, F. 14/AP-Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Jugosllavisë (MPKJ), V. 1948, D. 4, fl. 11. Letër e Enver Hoxhës drejtuar J. B. Titos, ku, ndër të tjera, shkruan edhe për njoftimin që kishte marrë mbi mundësinë e tërheqjes së këshilltarëve sovjetikë.

⁶⁷ Enver Hoxha kujton: “qysh pas paragrafëve të parë, po ndieja një gëzim e një satisfaksion, të tillë që rrallë i kisha provuar në jetën time.” Enver Hoxha, *Titistët* (Tiranë: 8 Nëntori, 1982), 445.

⁶⁸ Për takimin Hoxha-Vyshinski, burim i vetëm janë kujtimet e drejtuesit të PKSH-së. Burimet arkivore mungojnë, çka e bën të vështirë të kuptosh me detaje se çfarë është diskutuar. Duket se prokurori i Përgjithshëm sovjetik po mblidhte “prova” për “tradhtinë e Titos”, dhe kryekomunisti shqiptar ishte i gatshëm t’ia ofronte ato. Fakti që çështja shqiptare u paraqit në mënyrë të papritur në mbledhjen e Kominform-it, duke u identifikuar si “shkaku i menjëhershëm i konfliktit”, vërteton se ky mund të ketë qenë me të vërtetë qëllimi i takimit. *Shih*: Hoxha, *Titistët*, 483-500. Për diskutimin surprizë të çështjes shqiptare në mbledhjen e Kominformit, *shih*: L. Gibianskii, “The Soviet-Yugoslav split and the Cominform”, në N. Naimark & L. Gibianskii (eds.), *The establishment of communist regimes in Eastern Europe, 1944-1989* (USA&UK: Westview Press, 1997), 307.

⁶⁹ Në prill të vitit 1948, partitë komuniste të Rumanisë, Bullgarisë, Polonisë, Çekoslovakisë, Italisë e Francës kishin shkruar letra, në të cilat tregonin mbështetjen e tyre ndaj Stalinit dhe Bashkimit Sovjetik. Gibianskii, “The Soviet-Yugoslav split”, 301-302.

Europës Qendrore dhe Lindore, PKSH-ja ishte e vetmja që nuk kishte kontakte të drejtpërdrejta me sovjetikët. Qartazi, për Enver Hoxhën dhe drejtuesit e tjerë komunistë shqiptarë mungonin informacionet e duhura për të kuptuar se çfarë kishte ndodhur dhe po ndodhte midis drejtuesit të Kampit dhe njërit prej figurave më të njohura komuniste në Ballkan. Në pamundësi për ta kuptuar thellësinë e konfliktit, vonesa mund të lidhet me lojën pritëse, tipike për Hoxhën.

Nga ana tjetër, ai donte të legjitimonte veten si një autoritet moral, i cili kishte interesin e shoqërisë si fokus kryesor dhe kishte luftuar për të shpëtuar Shqipërinë. Nëse ai ishte heroi, atëherë historia kërkonte edhe një antihero, mbi të cilin ai kishte triumfuar. Vyshinski i kishte thënë qartë gjatë takimit se nuk është e rëndësishme sa i dënon armiqtë, por duhet të bindet populli për veprimtarinë dhe “të aprovojë vendimin” për dënimin e tyre.⁷⁰ Në rastin shqiptar, duke qenë se faktet nuk e mbështesnin gjithmonë këtë imazh, atij iu desh kohë për të ndërtuar portretin e fajtorit dhe “për t’ia faturuar” Xoxes jo vetëm fajin për marrëdhëniet me Jugosllavinë, por edhe të gjitha paudhësitë që kishin ndodhur në Shqipërinë e pasçlirimit. Xoxe u akuzua jo vetëm si agjent i jugosllavëve, por edhe si xhelati i shqiptarëve, ai që kishte shndërruar Sigurimin e Shtetit në një organ të gjithëpushtetshëm, i cili kontrollonte gjithkënd, përfshirë edhe sekretarin e Përgjithshëm të PKSH-së.⁷¹

Në fund të qershorit 1948, filloi një tjetër seri mbledhjesh të Byrosë Politike, gjatë të cilave u analizua situata në përputhje me konfliktin Stalin - Tito. Mbledhje pas mbledhjesh, Koçi Xoxe, Pandi Kristo, Kristo Themelko dhe mbështetësit e tyre u akuzuan si agjentë të jugosllavëve, të cilët kishin goditur vijën e drejtë të partisë dhe sekretarin e saj të Përgjithshëm, duke e izoluar atë. Opinioni i anëtarëve të PKSH-së, por edhe ai i publikut të gjerë u përpunua dalëngadalë dhe në vijimësi. Artikull pas artikulli në gazeta, plenum pas plenumi, u ndërtua një histori me të vërteta gjysmake, derisa në Plenumin XI të KQ të PKSH-së (shtator 1948) dhe në Kongresin I (nëntor 1948) kulti i Bashkimit Sovjetik dhe i Enver Hoxhës si shpëtimtarë të situatës u farkëtua qartë. Në fund të fundit, shqiptarët gjithnjë kishin ushqyer mosbesim, madje edhe armiqësi ndaj Jugosllavisë. Të besohej kjo narrativë antijugosllave në Shqipëri nuk

⁷⁰ Hoxha, *Titistët*, 486.

⁷¹ “Pjesë nga procesverbali i Komisionit Hetimor për Koçi Xoxen, 5 janar-7 maj 1949”, në N. Plasari, L. Malltezi (përg.), *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1945-1948)*, 541-547.

ishite gjithaq e vështirë.⁷² Sa për Koçi Xoxen, Kristo Themelkon e të tjerë,⁷³ fakti që ishin agjentë jugosllavë thjesht shtonte urrejtjen e grumbulluar të publikut ndaj tij si ministër i Brendshëm. Shqiptarët kishin qenë dëshmitarë të sjelljeve të dhunshme të organeve të Ministrisë së Brendshme nën drejtimin e Koçi Xoxes. Njerëz të zakonshëm, anëtarë partie dhe “të deklasuar” në të katër anët e Shqipërisë dërgonin letra ku dëshmonin për përndjekjet, survejimet, shantazhet, torturat dhe vdekjet në hetuesi. Sado që Xoxe përsëriste se të gjitha i kishte bërë me dijeninë, madje edhe me urdhrin e Enver Hoxhës, pak rëndësi kishte kjo për masën e gjerë të njerëzve. Të gjithë ndiheshin të kënaqur që u gjetën fajtorët e kësaj situate dhe, më në fund, ushqenin shpresën se e nesërmja do të ishte më e mirë.

Enver Hoxha kishte rifituar autoritetin e padiskutueshëm tanimë si Sekretar i Parë i KQ të PKS-së, kishte eliminuar rivalët e tij më të rëndësishëm në udhëheqje, madje kishte përmirësuar dukshëm edhe statusin e tij ndërkombëtar. Studiuesi Elidor Mëhilli ka të drejtë kur thotë se konflikti Stalin - Tito faktorizoi Shqipërinë e vogël në Kampin Socialist,⁷⁴ duke legjitimuar përfundimisht edhe autoritetin absolut të Enver Hoxhës si diktator i saj.

⁷² Raportet nga komitetet e PKS-së në qarqe vënë në dukje se denoncimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë ishte prituri mirë nga popullsia. Në Berat, p.sh., raportohet se “megjithëse racioni i bukës është ulur gjysmë për gjysmë ... mobilizimi i popullit për thirrjet që i bën partia është më i madh”. *AQSH*, F. 14/APStr., V. 1948, D. 4, fl. 120. Relacion 15-ditor i komitetit qarkor të PKS-së për Beratin, 1 tetor 1948.

⁷³ Pas vendimit për përjashtimin nga organet drejtuese të PKS-së dhe përjashtimit gjithashtu si anëtarë të saj, në shkurt 1949, Koçi Xoxe, Pandi Kristo, Vasil Koleci e shumë të tjerë mbështetës të tij u arrestuan dhe më vonë u dënuan. Koçi Xoxe u ekzekutua me vdekje.

⁷⁴ Elidor Mëhilli, “Defying De-Stalinization: Albania’s 1956,” *Journal of Cold War Studies* 13, no. 4 (2011): 4-56. <https://www.jstor.org/stable/26924042> (shikuar më 15.09.2024).

Burime dhe bibliografi:

Burime arkivore:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondi:

- F. 14/AP-OU, V. 1946, D. 1/1, D. 9
- F. 14/AP-OU, V. 1947, D. 1, D. 16, D. 20, D. 28
- F. 14/AP-OU, V. 1951, D. 1/3
- F. 14/AP-OU, V. 1985, D. 1
- F. 14/AP, V. 1948, D. K/25
- F. 14/AP, V. 1950, D. K/26
- F. 14/APL, V. 1943, D. 20, 21, 26
- F. 14/APL, V. 1944, D. 93, 103, 125
- F. 15/AP, V. 1938, D. 29
- F. 14/APStr., V. 1948, D. 4, 131/2
- F. 14/APMPKJ, V. 1948, D. 4
- F. 152, V. 1939, D. 24

Literaturë:

- BARUTI, Vasfi. *Enver Hoxha, gjysma tjetër e hënës*. Tiranë: ISKK, 2007.
- BOÇI, Sonila. "The December 2nd, 1945 Albanian Elections: Legalization, or mere formalization for Communist Power". In *Porta Balkanica* (2015), vol. 7, iss. 2, 16-19.
- FRASHËRI, Kristo. *Jeta e një historiani*. Kujtime. Tiranë: ASHSH, 2014.
- FRITZPATRICK, Sheila. *The Russian Revolution*. Second edition. Oxford: Oxford University Press, 2001.
- GIBIANSKII, Leonid. "The Soviet-Yugoslav split and the Cominform". In N. Naimark & L. Gibianskii eds., *The establishment of communist regimes in Eastern Europe, 1944-1989*. USA&UK: Westview Press, 1997.
- Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Shqipërisë*, vëll. 1. Tiranë: 8 Nëntori, 1984.
- Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë*. Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, pranë KQ të PPSH-së. Tiranë: 8 Nëntori, 1981.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. V (1945-1999). Drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, grup autorësh. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2023.

- HOXHA, Enver. *Kur lindi Partia*. Kujtime. Tiranë: 8 Nëntori, 1981.
- HOXHA, Enver. *Titistët*. Tiranë: 8 Nëntori, 1982.
- HOXHA, Enver. *Vite të rinisë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1988.
- LUBONJA, Todi. *Nën peshën e dhunës*. Kujtime, botim II. Tiranë: Mësonjëtorja, 1998.
- Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1944-1948)*, vëll. I. Përgatiti për botim Sabit Syla dhe Qerim Lita. Prishtinë: Instituti i Historisë, 2020.
- Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*. Përgatiti për botim Ndreçi Plasari, Luan Malltezi. Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996.
- MËHILLI, Elidor. "Defying De-Stalinization: Albania's 1956." *Journal of Cold War Studies* 13, no. 4 (2011): 4-56.
<https://www.jstor.org/stable/26924042> (shikuar më 15.09.2024).
- NAIMARK, Norman M. *Stalin and the fate of Europe, the postwar struggle for sovereignty*. London England, Cambridge, Massachusetts: The Belknap Press of Harvard University Press, 2019.
- Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi II i KQ të PKSH-së, 23-27 nëntor 1944*. Përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi. Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996.
- Politikë antikombëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSH-së, Berat 23-27 nëntor 1944*. Përgatiti për botim Ndreçi Plasari dhe Luan Malltezi. Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, 1996.
- TISMĂNEANU, Vladimir. *Stalinism for All Seasons_ A Political History of Romanian Communism*. California: University of California Press, 2003.

ASSOC. PROF. DR. SONILA BOÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
sonilaboci23@gmail.com

S u m m a r y

“THE TRAJECTORY OF A CULT: ENVER HOXHA AND THE MAKING OF A
STALINIST LEADER
(1944-1948)

This article investigates the genesis and architecture of the cult of personality surrounding Enver Hoxha during the early period of the Albanian communist regime. Drawing on archival materials,

contemporaneous testimonies, and internal party documents, the study examines how an individual with limited revolutionary credentials and minimal connections to the Bolshevik movement ascended to the leadership of the Albanian Communist Party (PKSh) and, subsequently, became the fulcrum of totalitarian legitimacy.

Analytical focus is divided into three phases. The first phase addresses Hoxha's rise to power, achieved through a series of favorable contingencies and his capacity to navigate factional struggles. The second phase traces the transformation of his public persona—from "people's commander" during the National Liberation War to "party leader" immediately afterwards. The final phase concerns the consolidation of his absolute authority between 1946 and 1948, via the interweaving of propaganda, political control, and the instrumentalization of both intra-party and international crises. The study also considers the roles of Miladin Popović, Nako Spiru, and Koçi Xoxe in navigating, enabling, or contesting these processes of power appropriation.

It is argued that Hoxha's cult was not a spontaneous outgrowth of popular adulation but a deliberately constructed political mechanism that combined elements of the Albanian authoritarian tradition with Stalinist models of legitimacy. Through this deliberate construction, Hoxha not only secured his own political survival but also established the ideological and institutional foundations of Albanian totalitarianism in the subsequent decades.

Keywords: Cult of personality, Enver Hoxha, totalitarianism, Albanian Communist Party, propaganda.